



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/60

Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet procesverbali dhe transkripti nga mbledhja: 45 e Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet korresponduese\elektronike: 52, 53, 54, 55, 56 57, 58 dhe 59 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah MOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 02/60  
Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Programi për Reforma në Ekonomi 2021-2023.
2. Obligohet Ministria e Financave që dokumentin nga pika 1. të këtij vendimi ta dorëzoj tek Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë.
3. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Programin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për informim Kuvendit të Republikës së Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 03/60

Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Vendimit Nr. 02/30 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 12.05.2020 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës, pas paragrafit 6, i shtohen paragrafët me numër rendor 6A dhe 6B me tekstin si në vijim:

6A. Rregullave të përcaktuara me këtë vendim nuk i nënshtrohen veturat që janë në shfrytëzim të Drejtorisë së Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës në kuadër të Administratës Tatimore të Kosovës. Këto vetura shfrytëzohen sipas nevojave të kësaj njësie dhe mund të regjistrohen me targa civile me Vendim të Ministrit të Punëve të Brendshme, sipas paragrafit 2 të nenit 51 të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2019 për Regjistrimin e Mjeteve.

6B. Këto vetura, me autorizim të Drejtorit të Drejtorisë së Hetimeve Tatimore dhe Inteligjencës ose Drejtorit të Përgjithshëm të ATK-së dhe me vendim të Ministrit të Punëve të Brendshme, mund të përdoren për qëllime operationale në çdo kohë edhe jashtë orarit të punës.

2. Obligohet Ministria e Financave, Administrata Tatimore e Kosovës dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**A r s y e t i m**

Mbretëria e Bashkuar është zotuar që do të ofroj një donacion me vetura për të mbështetur Drejtorinë e Hetimit dhe Inteligjencës Tatimore (D.HIT) brenda Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për t'i mundësuar kësaj të fundit përmbushjen e objektivave ligjore në parandalimin dhe zbulimin e krimit ekonomik, financiar dhe krimit të organizuar.

Duke marrë parasysh se aktiviteti i ushtruar nga D.HIT është i natyrës shumë të rëndësishme dhe specifike, pala britaneze ka kërkuar që veturat e dhëna si donacion të mos u nënshtrohen rregullave të përcaktuara me vendimin Nr. 02/30 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 12.05.2020 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Republikës së Kosovës.



Andaj, me qëllim të krijimit të kushteve për përfitimin e këtij donacioni, si dhe fuqizimit të kapaciteteve të D.HIT (Administratës Tatimore të Kosovës) në përmbushjen e objektivave ligjore sa i përket parandalimit, zbulimit të krimit ekonomik, financiar dhe krimit të organizuar, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Simjali



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/60  
Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Me qëllim të lehtësimit të ushtrimit të aktivitetit ekonomik të të gjithë tatimpaguesëve, si pasojë e gjendjes së vështirësuar ekonomike të krijuar nga pandemia COVID-19, merren masat si në vijim:
  - 1.1. Shtyhet bllokimi i llogarive bankare për të gjithë tatimpaguesit, që kanë obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), deri më datë 30.04.2021;
  - 1.2. Lirohen llogaritë e bllokuara të të gjithë tatimpaguesve, që kanë obligime tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), deri më 30.04.2021;
  - 1.3. Hiqen ndëshkimet për të gjithë tatimpaguesit që kanë detyrime tatimore të pashlyera në Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), nëse kryejnë pagesën e tatimit bazë dhe interesit deri më 30.06.2021.
2. Heqja e ndëshkimeve, sipas nënparagrafit 1.3, paragrafi 1, bëhet për të gjithë tatimpaguesit nëse:
  - 2.1. Tatimpaguesit bëjnë pagesën e njehershme të tatimit dhe interesit;
  - 2.2. Tatimpaguesit bëjnë marrëveshje me ATK-në për pagesë me këste;
  - 2.3. Tatimpaguesit janë në marrëveshje me ATK-në dhe paguajnë tatimin dhe interesin.
3. Obligohet Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) që gjatë kësaj periudhe të iu mundësoj tatimpaguesve të kryejnë obligimet tatimore bazuar në mundësitë financiare të tatimpaguesve, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit të tyre financiar.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Administratës Tatimore të Kosovës (ATK)
- Arkivit të Qeverisë

Simjali





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 05/60

Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 34 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar, të nenit 12, paragrafi 10, të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet alokimi i mjeteve financiare në vlerë prej dy milionë e tetëqind mijë euro (2,800,000,00 €), që përfaqëson shumën tremujore të ndarjes vjetore buxhetore vjetore, për periudhën Janar - Mars 2021, për Radio Televizionin e Kosovës, me kod buxhetor 248.
2. Autorizohet transferimi i mjeteve në baza mujore te Radio Televizioni i Kosovës (RTK), një të tretën (1/3) të shumës së aprovuar sipas pikës 1. të këtij vendimi, brenda 5 ditësh pas pranimit të kërkesës së RTK-së, e proceduar përmes Kuvendit të Kosovës, në rolin e themeluesit.
3. Shuma tremujore e alokuar sipas pikës 1. të këtij vendimi, dhe e transferuar te RTK sipas pikës 2. të këtij vendimi, është subjekt i rishikimit nga Komisioni përkatës për Buxhet dhe Transfere në Kuvend, menjëherë pas themelimit të tij.
4. Në rast se Komisioni përkatës funksional i Kuvendit, pas shqyrtimit në pajtim me nenin 12, paragrafi 10 i Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, konsideron se shpenzimet e tilla nuk janë të pranueshme, obligohet Thesari i Republikës së Kosovës që të bëjë ndalesë, përkatësisht kompensojë këtë shumë nga tremujorët vijues, me qëllim që përfundimisht vetëm shuma e aprovuar nga Komisioni me vendim të mund të shpenzohet dhe arsyetohet brenda vitit fiskal 2021 nga RTK.
5. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit, që këtë vendim t'ia përcjell Kryesisë së Kuvendit si dhe Sekretarit të Përgjithshëm, me qëllim që në takimin e parë të punës të komisionit përkatës funksional, të paraqitet raporti dhe procedohet më tutje, në pajtim me pikën 4. të këtij vendimi.
6. Autorizohet Thesari i Republikës së Kosovës, që të transferojë mjetet pas plotësimit të kushteve nga pika 2. e këtij vendimi, në llogarinë bankare të depozituar nga RTK në bankë komerciale.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

### Arsyetim

Sipas Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, nenit 12, par. 10, procedura e transferimit është përcaktuar si vijon, citim: "Para secilit tremujor, RTK-ja do të dorëzojë në Komisionin për Buxhet dhe Transfere në Kuvend, programin e shpenzimeve të planifikuara. Në fund të çdo tremujori, RTK-ja do të dorëzojë në Kuvend raportin për shpenzimet e bëra. Mjetet sipas këtij paragrafi alokohen dhe transferohen nga Thesari në llogarinë në bankë komerciale të përcaktuar nga RTK-ja, sipas vendimit të Komisionit për Buxhet dhe Transfere".

Meqë pas shpalljes së zgjedhjeve të jashtëzakonshme për Kuvendin e Kosovës, Komisioni për Buxhet dhe Transfere është shuar, me qëllim që të mundësohet funksionimi i transmetuesit publik dhe sipas kërkesës së RTK-së, përmes këtij vendimi aprovohet dhe autorizohet alokimi i mjeteve buxhetore dhe transferimi te RTK, për tremujorin e parë të vitit 2021.

Pas krijimit të rrethanave ligjore kur Komisioni themelohet, ky alokim i parakohshëm do të jetë subjekt i rishikimit nga Komisioni përkatës funksional, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Në rast të nevojës, shuma e alokuar do të ndalet, kompensohet nga tremujorët vijues, ashtu që vetëm shuma e aprovuar nga Komisioni të jetë përfundimisht e shpenzuar nga RTK, sipas ligjit të buxhetit.

Avdullah HODI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

#### Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/60  
Datë: 27.01.2021

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4, dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 24 të Ligjit Nr. 07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, bazuar në vendimin nr. 06/58 të datës 14.01.2021 lidhur me paragrafin 1 dhe 4, si dhe në zbatim të vendimit Nr. 04/59, të datës 21.01.2021 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës merr këtë:

**V E N D I M**

1. Ndahen mjete buxhetore në shumë prej një milion euro (1,000,000 €) për Agjencinë për Barazi Gjinore, në nën-programin Agjencia për Barazi Gjinore me kod 15300 në kategorinë e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere", në kuadër të organizatës buxhetore Zyra e Kryeministrit.
2. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij vendimi alokohen dhe shfrytëzohen sipas kriterëve përkatëse të aprovuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit nr. 04/59, të datës 21.01.2021.
3. Mjetet e ndara sipas paragrafit 1. të këtij vendimi merren nga Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike, nën-programi "Programi i Rimëkëmbjes Ekonomike (MF)" me kod 29300, kategoria e shpenzimeve "Subvencione dhe Transfere".
4. Obligohet Ministria e Financave dhe Zyra e Kryeministrit - Agjencia për Barazi Gjinore për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---

Nr. 07/60  
Datë: 27.01.2021


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 të Ligjit Nr. 04/L-198 për Tregtinë e Mallrave Strategjike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 27 janar 2021, merr këtë:

**V E N D I M**

1. Formohet Komisioni për Kontrollin e Tregtisë me Mallra Strategjike në këtë përbërje;
  - 1.1. Zana Kotorri / MTI - kryesuese;
  - 1.2. Behram Mazreku / MTI - zëvendës kryesues;
  - 1.3. Brahim Kokollari / MM - anëtar;
  - 1.4. Nazmi Zogaj / MM - zëvendës anëtar;
  - 1.5. Bujar Haxhidauti / DK - anëtar;
  - 1.6. Bujar Pefqeli / DK - zëvendës anëtar;
  - 1.7. Mensur Hoti / MPB anëtar;
  - 1.8. Driton Ademi / MPB zëvendës anëtar;
  - 1.9. Adnan Dragaj/ MPJ - anëtar;
  - 1.10. Flurin Gashi /MPJ - zëvendës anëtar.
2. Komisioni do të jetë përgjegjës për aprovimin, anulimin, ndryshimin dhe revokimin e licencave për eksport, import, transit, trans-ngarkim, ri-eksportim jashtë territorial, ri-transferim dhe për ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura.
3. Komisioni do të përcaktojë Listën Shtetërore të Mallrave të Kontrolluara Strategjike.
4. Sipas nevojës dhe rrethanave, Komisioni mundë të kërkoj informata shitesë dhe ekspertizë prej institucioneve relevante të Republikës së Kosovës.
5. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për sigurimin e hapësirës dhe mbështetjes teknike për Komisionin.
6. Shfuqizohen Vendimet e Qeverisë: Nr. 04/90 i datës 19.02.2019 dhe Nr. 11/15 i datës 22.07.2020.

7. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Avdullah HOTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

# Simjali